

FEIM GJOKUTAJ



BIBLIOTEKA
SHTETIT

94 P. 65

91 9L

NE DALLGET E LUFTES

149.65

8791

FEIM GJOKUTAJ

NË DALLGËT E LUFTËS

(Kujtime)



SHTËPIA BOTUESE "8 NËNTORI"

KUSH KUNDËRSHTON, PUSHOHET NGA PUNA!

Në barakën tonë të vogël ishin mbledhur shumë vetë atë mbrëmje të nëntorit të vitit 1941. Drejtoria e ndërmarrjes kishte nxjerrë një urdhëresë, e cila jo vetëm që na habiti, por edhe na shqetësoi, sidomos me fjalët: «Punëtorët shqiptarë duhet të shkojnë e të regjistrohen në zyrën e fashios. Për këtë ata do të shpërblehen me një kostum doku dhe do t'u dhurohet nga një këmishë e zezë. Kush kundërshton, pushohet nga puna! Afati për t'u menduar dhjetë ditë!...»

Ishte e vështirë për ta kuptuar ne analfabetët domethënien e asaj urdhërese. Deri më sot ata nuk na kishin dhënë as hakun e punës, ndërsa tani deshën të na shpërblejnë. Diskutonim për të gjetur shkakun e kësaj gjëje, por nuk i jepnim dot udhë. Diçka luhej në këtë mes.

Në barakë flinim rreth 30 vetë mbi thasët e çimentos. Kur u hap lajmi i «zemërgjerësisë italiane» te ne u mblodhën edhe shokë të tjerë dhe filluam ta shoshitim punën, por asnjëri nuk mund të sqaronte se çfarë fshihej pas kësaj. Në kokë na lindnin shumë përsëra. Ndërsa diskutonim më erdhën në

mëndje momente të jetës së kaluar në fshatin tim të lindjes, kur bridhja pas bagëtive në kodra e lëndina dhe zemrën ma pushtoi mallëngjimi. Kisha di-sa kohë që s'kisha qënë në shtëpi.

...Lufta Italo-Greke kishte mbaruar, por gjendja në këtë zonë, që ishte dëmtuar rëndë nga lufta, ishte e vajtueshme. Dimri pë afrote dhe ne ishim pa ushqim. Kishim mbetur në mes të katër udhëve. Zona jonë ishte blegtorale dhe unë gjithë jetën e kisha kaluar si bari. U përpoqa përsëri të futesha çoban te ndonjë i pasur, por me shpërblimet që më ofronin agallarët e Delvinës e të Gjirokastrës nuk siguroja dot as veten. Kjo gjendje më detyroi, ashtu si shumë bashkëfshatarë, të shkoja si punëtor krahu te një shoqëri italiane në Vlorë. Punën e kishim të vështirë; gjithë ditën transportonim gurë, hekura, dërrasa, gëlqere, çimento e gjithfarë materialesh të tjera ndërtimi. Lodheshim e dërrmoheshim, por shpërblimi ishte i pakët. Vetëm pas punës, kur mblidheshim të gjithë dhe fillonim bisedit, sikur i harronim pak telashet e ditës. Kujtonim tufat me bagëti, bukuritë e fshatit dhe ndienim mall. Ëndërroja përsëri të merrja kërrabën në dorë, të vija tufën e bagëtive përpara, të merrja fyellin dhe të harroja të gjitha vuajtjet. Harroeshim një copë herë të mirë pas këtyre kujtimeve të së kaluarës, tingujve të këmborëve, kërrabës dhe culës, por kur mendonim gjendjen në të cilën ndodheshim trishtimi bëhej më i madh dhe në zemrën tonë ndizej urrejtja kundër atyre që u bënë shkaktarë të të gjitha këtyre mundimeve. Mëngjesi na zinte duke punuar, edhe nata na gjente përsëri në punë. Shpërblimi që i vajtueshëm, por duhej të je-

tonim, prandaj ulnim kokën dhe punonim gjithë ditën.

— S'e keni bërë asnjëherë normën! — na thoshte kapurali, kur na jepte shpërblimin për punën që bënim dhe një notë përçmimi ndihej në zërin e tij. — Po të doni të merrni më shumë, punoni më tepër! Dhe na kthente krahët. Qenë pak për të që rropateshim gjashtëmbëdhjetë orë në ditë, në vapë e në ngricë, herë të ngrënë e herë të pangrënë.

Mblidheshim kokë më kokë dhe bisedonim për gjendjen në të cilën ndodheshim.

— Eh fukarallëk! — pëshpëriste shpesh Sadik Leli, — s'thonë kot «fukarallëku të fut atje ku s'ta merr mendja». Vajtëm kaq muaj që punojmë si qetë dhe atë të shkretë normë si s'mundi ta realizojë asnjëri nga ne, qoftë dhe një herë të vetme.

Mendoheshim e flisnim, por s'dinim çfarë të bënim për të dalë nga kjo gjendje ku kishim rënë. Na shkante në mendje ta vrisnim kapuralin dhe mbikqyrësin italian, por prapë hiqnim dorë nga ky mendim. E dinim se do t'i zëvendësonin me të tjerë dhe neve nuk do të na ndaheshin telashet. Punën më të rëndë e bënim ne, punëtorët shqiptarë, por pagën e kishim shumë të ulët. Ndryshe ndodhte me punëtorët italianë. Jo vetëm që paguheshin më mirë për punë më të lehtë, por ata kishin dhe mensë dhe rroba pune. Kurse neve kur kërkuam që të hanim në mensën e tyre, na u përgjigjën:

— E kemi të vogël! Kur të ndërtojmë tjetrën do ta rregullojmë dhe punën tuaj!

Këto ishin vetëm fjalë, se as që kujtohej njeri për jetën tonë. Vetëm punë donin prej nesh, pale që jetonim si qentë. Të gjitha këto që hiqnim na

e mbushën mendjen se duhej bërë diçka për ta ndryshuar vetë gjendjen tonë.

Këto mendonim dhe në ato net kur baraka jonë ziente nga bisedat, për të gjetur atë që fshihej pas urdhëresës së drejtorisë. Asnjëri nuk e ndjeu kur erdhi në barakën tonë Hamiti, ose sejmeni i kapuralit siç e quanim ne atë, se nuk ndahej asnjë hap nga kapua. Kur dëgjoi që bisedonim për problemin e urdhëresës tërë kapadaillëk tha:

— Duçes i vjen keq për ne që jemi katandisur në këtë gjendje. Si fillim do të na japë këto, kurse më vonë plot gjëra të tjera.

Për pak çaste në barakë zotëroi një heshtje e rëndë. Të gjithë mendonim rreth atyre që tha i porsardhuri; nuk na pëlqyen ato fjalë, por asnjëri nuk po vendoste që t'i kthente përgjigje. Ishte Sadiku ai që me ironi iu drejtua:

— Kush e di sa net pa gjumë do të ketë kaluar i shkreti Duçe duke menduar për këtë dhuratë kaq të madhe, që me siguri do të na nxjerrë nga fukarrallëku në bollëk.

— Nuk i thonë shaka, — ia priti një tjetër, — një kostum e një këmishë, më vonë besoj se do të na japë edhe nga një palë benevrekë, apo jo?

Si mbaroi fjalën u kthye nga ne e na shkeli syrin. **Ia dhamë të qeshurit. Secili filloi të thotë ndonjë** fjalë që i godiste rëndë Hamitit. Shanim fashizmin dhe këlyshët e tij. Kështu vazhduam një copë herë. Hamiti u mundua të thoshte diçka tjetër, por të qeshurat tona nuk e linin të vazhdonte, prandaj përplasi derën dhe u zhduk.

— Kësaj i thonë, — vazhdoi tërë inat Sadiku, — le gomari që na ngordhi, por s'na lënë rehat as mizat.

— Po e mbush kupën ky dhe ta dini po e mbërtheva ndonjë ditë s'ka për të bërë më hije mbi tokë, — tha tërë urrejtje Mitati.

— Po, po! — u përgjigjën shumë vetë bashkë, — e kërkon si breshka ai.

— E ku e patëm fjalën! — pyeti një zë dhe po vetë vazhdoi, — që ka një..., si i thonë andej nga fshati ynë, në këtë mes. Po hëni ju kam rixha, gjejeni. Kot nuk na e japin atë këmishë të zezë.

— Këtë do t'ua japin vetëm atyre që do të regjistroheshin në zyrën e fashios — ia priti një tjetër. Ndërsa ata që nuk do ta bëjnë këtë gjë do të flaken nga puna.

— Edhe unë ashtu mendoj, — pohoi Memushi. — Kjo s'duhet të jetë dhuratë si na thonë. Djalli e di se ku do t'i dalë tymi...

— Mos e vrisni mendjen kot së koti, pyesim nesër ata të barakave të tjera. Do të gjendet ndonjëri që t'i japë udhë kësaj pune. Tani më mirë të flemë se do të ngrihemi që me natë, — foli njëri andej nga fundi i barakës.

— Po të të flihet, fli! — ia ktheu tërë inat një tjetër, që ndodhej pranë tij. Neve nuk na flihet. Ti vetëm kokën ke, kurse unë kam një barrë fëmijë, si unë janë dhe pjesa më e madhe këtu.

Pasi heshti pak na u drejtua të gjithëve:

— Unë, o vëllezër, mendoj se këto «dhurata qesharake» do të jenë ndonjë lak. Prandaj duhet të kemi kujdes.

Përsëri zotëroi heshtja. Secili e pleqëronte me veten e tij se cila do të ishte rruga më e mirë për të vepruar. Kështu, me hamendje, shkoi gjatë. Kur, aty nga mesi i barakës u dëgjua një zë i trashë, që dukej sikur i përtypte fjalët me vështirësi:

— Le të jenë ç'të duan. Unë për veten time nuk kam nga t'ia mbaj. E kam kthyer nga të gjitha anët, po njëri krah më del më keq se tjetri. Prandaj meqë keq se keq do të regjistrohem.

Heshti pak dhe pastaj vazhdoi:

— Dhe këtë e bëj jo i shtyrë nga kostumi që është si ato thasët e çimentos, as nga këmisha dhe as nga ato pallavrat e tjera, që na tregoi pak më parë Hamiti, por nga halli. Ku të mbytem po të më përjashtojnë nga puna? Nënë e kam mbi 80 vjeç, gruaja vajti muaj që dergjet e s'po i gjendet dermani, fëmijën më të madh e kam dymbëdhjetë vjeç, kurse më të voglin dy. Të gjashtë fëmijët dhe nëna me gruan presin kacidhet, që më jep kapurali. As vëllezër e as motra s'kam, që t'u kërkoj ndihmë. Sa për dimrin ç'tju them, e shihni vetë si e nisi.

Tha këto dhe përgjoi tërë ankth se mos e kundërshtonte njeri vendimin që kishte marrë. Fjalët e tij na zhytën në mendime të thella. Pesë më poshtë, pesë më lart në atë gjendje qemë thuaj të gjithë.

— Si ta shohësh më mirë, — tha Shaban Idrizi duke iu drejtuar atij që pak më parë ishte ankuar. — Gjithësekush e di vetë se ku i pikon shtëpia. Unë për vete e kam vendosur; më mirë të vdes bashkë me fëmijët sesa të regjistrohem. Kjo urdhëresë nuk duhet të jetë nga drejtoria e ndërmarjes. Tek të bëj ndonjë të pabërë, më mirë po iki vetë.

— Ti që flet ashtu serbes, — iu drejtua njëri Shabanit, — do të kesh ndonjë rezervë, nuk do të jesh fishek fare si ca nga ne.

— Po të kisha, — ia ktheu Shabani i pezmatuar, — nuk do të kisha ardhur këtu. Edhe mua fukarallëku më pruri.

— Ajo kuptohet, — u dëgjua po ai zë, — por si t'ia bëjmë? Unë jam më keq se ky shoku. Në fshatin tim dëbora ka filluar që tani dhe nga fundi i marsit pa të shohim kur të iki. Hë, të lutem, më thuaj si të bëj?

Një burrë i moshuar nga Vlora, që gjatë gjithë kohës vetëm kishte dëgjuar dhe nuk kishte marrë pjesë në bisedë, pa një herë të gjithë shokët dhe pastaj tha:

— Të dyja këto janë të vështira, por edhe midistyre njeriu mund të zgjedhë atë që është më pak e keqe. Duhet shoshitur mirë kjo punë. Mbase zgjedhim atë që na leverdis tani, regjistrimin, po ku ta dish ç'fshihet pas tij. Të kemi kujdes se mos përpiqemi të vëmë vetulla e nxjerrim sytë. E dini atë fjalën që tha i pari: «Jep një qindarkë e hyn në valle, jep njëqind e nuk del dot pastaj!» Prandaj mendoni mirë e mos u nxitoni.

— Këto diskutime vazhduan deri vonë, por asgjë nuk u bë e qartë. Përmes fjalëve që u thanë dilte në pah urrejtja e secilit për ata që e kishin hartuar këtë urdhëresë. Të gjithë ishim të shqetësuar nga kjo që po ndodhte dhe nuk dinim si të vepronim. Kishim frikë se mos hynim në ndonjë qorrsokak e hajde të dilje pastaj. Nervozizmi na kishte pushtuar të gjithëve. Secili e pleqëronte me veten dhe me shokët atë që duhej të bënte, por asnjë vendim nuk merrte. Gjithë atë natë që u zhvilluan këto biseda qëndroja shtrirë pa marrë pjesë, por bluaja me mendje. Edhe kur ra qetësia e shokët i zuri gjumi njerin pas tjetrit, unë mendoja rreth atyre që u thanë. Nuk ishte e lehtë për të vendosur. Unë kisha një tuftë fëmijë. Koka më qe rënduar e s'i jepja që s'i jepja dot dum. Pati momente që e përfytyrova veten të

veshur me atë kostum doku e këmishë të zezë, por m'u rrëqeth trupi. Flokët m'u ngritën përpjetë kur mendova se ato s'ishin rroba, por kapistër që kush e di nga do të më tërhiqnin.

«Jo, jo! Kurrë nuk do të lejoj të më hipin në kurriz e të më heqin për hunde, — thashë me vete. — Zemëkatrani na u bënë për një natë zemëbardhë. Ujku nuk mund të bëhet qengj! Edhe unë do të veproj si Shabani!» — vendosa më në fund. Kjo sikur më qetësoi pak dhe më zuri gjumi.

Të nesërmen takova Ali Lalën, një kushëririn tim, që banonte në Vlorë. Ai m'u drejtua me një qortim vëlazëror:

— Dje mësova që punoke në këtë ndërmarrje. Më ka ngelur qejfi me ty. Kaq kohë këtu dhe s'ke ardhur të na takosh. Pastaj biseduam për punën; më pyeti gjerë e gjatë se si na trajtonin italianët.

— Mirë që u takuam sot, — i thashë, — e i tregova punën e urdhëresës. Ai dëgjonte dhe vetëm herë pas here tundte kokën duke miratuar fjalët e mia. Pasi u mendua pak m'u drejtua:

— Pse s'thua që qenkeni në hall. Po dhe sa ditë ju kanë mbetur? Çfarë keni vendosur të bëni? Dhe pyetjet e tij pasonin njëra-tjetrën. Pastaj më porositi të shkoja të merrja shokët dhe të bisedonim shtruar. Kur u mblodhëm të gjithë dhe shkonim rrugës kaluam pranë një varri.

— I kujt është ky varr? — pyeti njëri nga ne.

— I Avni Rustemit, — u përgjigj Aliu.

Kjo sikur e sollti bisedën atje ku na rrinte mendja.

— Për çdo gjë, të dashur vëllezër, duhet guxim, trimëri dhe zgjuarsi, — vazhdoi Aliu pas pak. — Kush ka këto veti, do të dalë gjithmonë fitimtar, ashtu siç